



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2020:131587  
Datë: 08.03.2024  
Numri i dokumentit: 05428437  
C.nr.394/2020

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Avdullah Mecinaj, ne çështjen juridike kontestimore e paditësit B.J.me vendbanim ne Skenderaj, Rr..., me nr.personal... te cilin me autorizim e përfaqëson J.O. avokat ne Prishtinë, Rr..., kundër te paditurës K... shpk me seli ne Glllogoc, lagjja... me pronar B.L. te cilën e përfaqëson me autorizim R.K. avokat ne Prishtinë, për kompensimin e demit material dhe jo material, pas përfundimit te seancës kryesore publike me dt. 18.01.2024 jep këtë.

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet pjesërisht kërkesëpadia e paditësit B.J.si e bazuar.

II. Detyrohet e paditura K... shpk, me seli ne Glllogoc lagjja... me pronar B.L. qe ne emër te demit material dhe jo material, te pësuarra për shkak te lëndimit ne pune me dt.17.07.2020 ne Veternik – komuna e Prishtinës, ti paguaj paditësit B.J.:

Për demin jo material:

- për dhimbje trupore – fizike shumen prej -----1300 €.
- për friken e përjetuar shumen prej-----1000 €.

Ne shume te përgjithshme prej 2300 euro me kamat ligjore 8% nga data e gjykimit 18.01.2024 e deri ne pagesën definitive ne afat prej 15 dite nga marrja e këtij aktgjykimi nen pasojat e përmbarimit.

Për demin material:

- për ushqim te përforcuar shumen prej-----210€.
- ne emër te ndihmës nga personi tjetër shumen prej -----300€.
- ne emër te rehabilitimit fizioterapeotik shumen prej -----150€

Ne shume te përgjithshme prej 660 euro, me kamat ligjore 8% nga datat e parashtrimit te padisë ne gjykate 08.09.2020 e deri ne pagesën definitive ne afat prej 15 dite nga dita e marrjes se këtij aktgjykimi e nen pasojat e procedurës përmbarimore.

III. Refuzohet pjesa e kërkesëpadisë përtej shumave te gjykuara si në piken II si e pa bazuar.

IV. Refuzohet pjesa e kërkesë padisë ne emër te kompensimit për demin jo material dhe material për shkak te aksidentit ne punë me dt:10.07.2020 ne fshatin... komuna e Pejës si e pa bazuar.

V. Obligohet e paditura K... shpk me seli ne Gillogoc, qe ne emër te shpenzimeve te procedurës kontestimore paditësit B.J.ti kompensoi shumen prej 1994 euro, ne afat prej 15 dite nga marrja e këtij aktgjykimi, ndërsa refuzohet si e pa bazuar ne emër te shpenzimeve te procedurës kontestimore shuma prej 1832 euro.

VI. Obligohet paditësi qe ne emër te taksës gjyqësore ta paguaj diferencën ne shume prej 30 €, ne afat prej 7 dite nga dita e marrjes se këtij aktgjykimi.

### A r s y e t i m

Paditësi B.J. përmes te autorizuarit ka parashtruar padinë ne ketë gjykate kundër te paditurës, për kompensim demi jo material dhe material, për shkak te pretendimeve se ka pësuar lëndime trupore ne vendin e punës ne fshatin... me dt:10.07.2020 dhe ne vendin e punës ne Veternik, duke kërkuar shumen e tërësishme prej 22000 euro (njëzet e dy mije euro) me kamat ligjore 8% nga dita e lëndimit me dt:10.07.2020 e gjer ne pagesën definitive.

I autorizuari i paditësit ne seancat e shqyrtimeve gjyqësore dhe me parashtrësën për precizimin e padisë si dhe ne fjalën përfundimtare deklaroi se nga provat e administruara është vërtetuar pa mëdyshje baza juridike e kërkesë padisë duke marre parasysh se kemi raportet e inspektoriatit te punës te cilat e kanë vërtetuar gjendjen faktike ne kohen e ndodhjes se lëndimit te paditësit ne vendet e punës tek e paditura e cila rrethane është vërtetuar edhe nga ekspertiza e mbrojtjes dhe sigurisë ne pune e cila ne mënyre te çartë dhe bindes ka përcaktuar formën dhe shkallen e përgjegjësisë te ndodhjes se lëndimit ne pune përkatësisht te palës se paditur, gjithashtu sa i përket lëndimit qe është vërtetuar nga dëshmitë e dëshmitareve qe janë dëgjuar ne ketë gjykate nga te cilat vërtetohen edhe fakti se paditësi ne kohen e lëndimeve ka qen duke punuar për te paditurën ne objektet e përshkruara si ne padi.

Sa i përket lëndimit te shkaktuara është jo kontestuese se paditësi është lënduar ne vendin e punës i cili fakt është vërtetuar me provat e administruara por gjithashtu edhe me raportet mjekësore dhe ekspertiza mjeko-ligjore e cila ka vërtetuar shkallen e lëndimeve dhe pasojave te tyre te lëndimeve, andaj paditësi konsideron se e paditura është përgjegjëse për kompensimin e demit te paditësit sipas përgjegjësisë subjektive qe rrjedh sipas ligjit sepse nuk i ka krijuar kushtet e duhura për kryerjen e punëve ne mënyre te sigurt pra mban përgjegjësi subjektive për shkak se nga provat e vërtetuara është vërtetuar fajësia për demin e shkaktuar dhe e paditura është përgjegjëse edhe sipas përgjegjësisë objektive sepse nuk i ka krijuar kushtet qe pune marrësi te punoi ne mënyrë te rregullt dhe pa pengesa gjate kryerjes se orarit te punës, fakt i vërtetuar edhe nga mendimi i ekspertit i mbrojtjes se sigurisë ne pune i cili ka përcaktuar te gjitha lëshimet e te paditurës qe ka sjell deri tek lëndimi i paditësit ne vendin e punës e për te cilat e paditura mban përgjegjësi objektive për kompensimin e demit.

Andaj i propozoi gjykatës qe kërkesë padinë e paditësit ta aprovoi ne tersi si te bazuara.

I kërkoi shpenzimet e procedurës për përpilimin e padisë shumen prej 208 euro, precizimi i padisë shumen prej 208 euro, taksen për padi shumen prej 30 euro, për ekspertizën e mbrojtjes dhe sigurisë ne pune shumen prej 380 euro, për ekspertizë mjekësore shumen prej 300 euro, dhe për pjesëmarrjen ne seanca për secilën veç e veç nga 270 euro për 10 seanca shumen prej 2700 euro, e ne shume te përgjithshme prej 3826 euro.

I autorizuari i te paditurës deklaroi se pas administrimit te provave është me e çartë se çdo aprovim eventual i kërkesë padisë se paditësit do ti shkelte te drejtat kushtetuese dhe ligjore te

paditurës, qe nga fillimi i kësaj çështje paditësi edhe pse ka pasur barrën e te provuarit, asnjëherë nuk ka mundur ta provoi se është lënduar ne vendin e tij te punës, qe nga dorëzimi i përgjigjes ne padi si i autorizuari i te paditurit kam dhëne për gjykatën dhe për palët ne dispozicion një sere provash, përkatësisht dy vendime te inspektoriatit te punës dhe një aktvendim te Prokurorisë Themelore ne Peje, fillimisht ne ketë vendime nder te tjera është potencuar nga njeri prej inspektoreve se lëndimi i paditësit nuk mund te vërtetohet me asnjë prove te vetme për kundër deklaratës se tije se i njëjti pretendon se është lënduar tek e paditura, po ashtu edhe aktvendimi i Prokurorisë Themelore ne Peje pas një hetimi ekstenziv nga dëgjimi i disa dëshmitareve konstaton se deklaramet e paditësit janë kundër thanëse dhe se i njëjti ka filluar te marr raporte mjekësore 15 dite pas pretendimeve për lëndim.

Prokurori konstaton faktin se paditësi vetëm qe te pasurohet ne dëme te paditurës ka filluar edhe vizita mjekësore qe te fitoi bazën juridike te parashtrimit te padis civile, edhe raporti i inspektorit tjetër konstaton se paditësi te gjitha raportet mjekësore i ka vetëm konsultime dhe ne asnjë raste nuk kemi një diagnoze për një lëndim eventual fizik, gjithashtu nga provat e ofruara nga paditësi asnjëherë nuk ka pasur rëngën apo CT, qe do te dëshmonin apo do te vërtetonin faktin qe kemi te bëjmë me lëndime, dhe përfundo lidhjen kauzale ndërmjet pretendimeve për lëndime edhe vet eksperti qe është dëgjuar ne ketë seance ka pohuar se e ka bere sipas raportit mjekësore te dt:21.07.2020 dhe ku ky ekspert po ne ketë seance ka thëne se sa i përket këtij raportit mjekësore se është jo relevant, sepse nuk ka vule te protokollit dhe as emrin e mbiemrin e mjekut.

I kërkoje shpenzimet e procedurës përkatësisht për 10 seanca te mbajtura nga 270 euro për seance ne teri pre 2700 euro.

Gjykata me propozimin e palëve administroi si prova: raporti zyrtar lidhur me aksidentin ne pune nr.1547 i dt:17.08.2020, raporti zyrtar lidhur me inspektimin e kryer ne subjektin juridik T... shpk i dt:16.09.2020, aktvendimi PP/II nr.1480/2020 i dt:14.10.2020 nga Prokuroria Themelore ne Peje, kartela ndihmese sociale e dt:03.09.2020, deklarimin e dëshmitareve B.K., A.B., Ç.M., ekspertizë mjekësore C.nr.394/2020 e dt:24.07.2023, ekspertiza C.nr.394/2020 e dt:07.07.2023 lidhur me shkaqet e lëndimit ne pune, ekspertizë C.nr.394/2020 e dt: 14.08.2023 lidhur me shkaqet e lëndimit ne pune me dt:17.07.2020 ne Veternik Prishtine.

Pas vlerësimit te secilës provë veç e veç dhe te gjitha ne tërësi ne kuptim te nenit 8 te LPK gjykata vërtetoi se:

Gjate procedurës se provave u konstatua se ne mes palëve ndergjyqjse është kontestuar se çështja se paditësi është lënduar ne dy vendet e punës tek e paditura siç pretendon pala paditëse ndërsa, pala e paditur pretendon se paditësi nuk ka pësuar lëndime trupore ne vendin e tije te punës.

Nuk është kontestuese se paditësi ka qene ne marrëdhënie pune tek e paditura pa e lidhur kontratën e punës.

Për ta vërtetuar përgjegjësin e palëve ndergjyqjese gjykata ka caktuar ekspertin gjyqësor A.K., për mbrojtje dhe siguri ne pune i cili ne ekspertizën e hartuar me shkrim C.nr.394/2020 e dt.11.07.2023 lidhur me shkaqet e lëndimit ne pune te punëtorit B.J. dhe sqarimet ne pyetjet e palëve ndergjyqjse gjate shqyrtimit gjyqësor dha mendimin profesional se shkaqet e ngjarjes se ndodhur me dt:10.07.2020 janë lëshimet e evidentuara nga ana e punëdhënësit – k... te evidentuara ne kuadër te këtij vendimi, prandaj edhe përgjegjësia për ngjarjen e ndodhur (rrëzimin e armaturave) është vetëm e punëdhënësit k... shpk, ndërsa punëtori B.J.me asnjë veprim / mos veprim, nuk ka dhëne kontribut qe ngjarja me dt:10.07.2020 ne objektin e ujërave te zeza ne fshatin... te ndodhë dhe ne shkresat e lendes nuk ka shënime /prova te cilat tregoni se

punëtori B.J.ka pësuar lëndime ne ketë raste edhe pse kemi kërkuar prova nga palët ne procedurë me qellim te konstatimit te kësaj çështje por te njëjta nuk janë ofruar nga asnjëra palë.

I autorizuari i palës paditëse propozoi gjykatës plotësimin e kësaj ekspertize lidhur me shkaqet e lëndimit ne pune te paditësit pasi qe paditësi ka pësuar lëndime trupore edhe me dt:17.07.2020 ne Veternik i cili ka qen duke punuar tek e paditura.

Eksperti gjyqësor A.K. ekspert për mbrojtje dhe siguri ne pune i cili ka plotësuar ekspertizën, C.nr.394/2020 e dt:14.08.2023 me rastin e lëndimit te punëtorit – paditësit dhe me prezantim ne shqyrtimin gjyqësorë pas sqarimeve ne pyetjet e palëve ndergjyqjse ka dhëne mendimin profesional se bazuar ne dokumentacionin ne shkresat e lendes se ne ngjarjen e ndodhur me dt:17.07.2020 ne objektin ne ndërtim ne Veternik te Prishtinës kanë ndikuar lëshimet e k... shpk dhe lëshimet e punëtorit –paditësit B.J.ashtu qe e paditura ka bere këto lëshime pasi qe nuk e ka bere vlerësimin e rrishtit te vendeve te punës për punëtoret e saje qe do te kryejnë veprime punuese ne atë objekt, nuk ka angazhuar organ mbikëqyrës (menagjer te kontratës) me kompetencë profesionale i cili do te mbikëqyrte veprimet punuese ne objekt, nuk ka angazhuar person kompetente nga lëmia e sigurisë dhe mbrojtjes ne pune, nuk ka ndermarrur masat adekuate teknike për kryerjen e veprimeve punuese ne forme me te lehte dhe te sigurt me rastin e përgatitjes se konstruksionit mbajtës te pllakës se betonit, ka angazhuar ne pune punëtorin B.J.pa kontratë te punës, nuk ka dërguar punëtorin para angazhimit ne pune ne kontrollim mjekësore ne mënyre qe te merr mendimin e mjekut/ mjekeve , ne lidhje me gjendje shëndetësore te tije, aftësitë fizike dhe psiçike për punët ne te cilat ka qene i angazhuar dhe nuk ka bere trajnimin e punëtorit –B.J.nga siguria dhe mbrojtja ne pune, ndërsa lëshimet e paditësit – punëtorit B.J.janë se ka pranuar te filloi punën pa nënshkruar paraprakisht kontratën e punës, ka kryer veprime punuese ne lartësi duke shkelur ne sipërfaqe te pa sigurte (ne doke –profile) andaj se është e kuptueshme dhe e logjikshme se përgjegjësia është ne përpjesëtim te drejte me lëshimet e palëve ne procedure dhe e paditura është përgjegjëse, dominonte-primare.

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit te kësaj ekspertize dhe sqarimeve shtesë ne te cilën eksperti ne mënyre profesionale dhe shkencore e bazuar ne dispozita ligjore bindshëm ne mënyre reale argumentoi përgjegjësinë primare te punëdhënësit ( te paditurës) dhe përgjegjësinë sekondare te paditësit andaj gjykata vërtetoi se ne ketë çështje ekziston përgjegjësia e ndare (e pjesëtuar) dhe kjo bazuar ne nenin 176.1 Ligji i Marrëdhënieve te Detyrimeve te cilën përgjegjësi nuk e kontestuan palët ndergjyqjese.

Konstatimin dhe mendimin profesional për natyrën e lëndimeve trupore dhe pasojat e tyre qe ka pësuar paditësi gjykata ka caktuar ekspertet gjyqësor Dr.S.D. ortoped – traumatolog dhe Dr.Sh.H. psikiatër te cilët ne ekspertizën e hartuar C.nr.394/2020 te dt:24.07.2023 për vlerësimin mjekësore për natyrën e lëndimeve trupore dhe pasojat për B.J. i cili bazuar ne dokumentacionin mjekësorë ne shkresat e lendes dhe ekzaminimi fizik i drejt për drejt i paditësit kanë dhëne mendimin se paditësi ka pësuar ndrydhje e regjionit te dy nen gjunjëve, plage gërvishtëse ne regjionin e te dy gjunjëve, ndrydhje e regjionit te gishtit te madhe te dorës se majte, reacion ndaj stresit akut te cilat lëndime klasifikohen si te lehta trupore dhe kane shkaktuar dhimbje fizike te intensitetit posaçërisht te rende nuk ka përjetuar, e intensitetit te rende qe kanë zgjatur për 48 ore, e intensitetit te mesëm qe kanë zgjatur për 3 jave dhe e intensitetit te ulte kanë qene prezentë ne periudhën kohore prej 12 muajve, ka përjetuar frik primare ne kohëzgjatje prej 2-5 sekonda, frikë sekondare te intensitetit te larte te cilat kanë zgjatur 1 ore, frike sekondare te intensitetit te mesëm qe ka zgjatur 2 muaj, frikë sekondare e intensitetit me te ulet janë shqetësimet e kohe pas kohëshme edhe për 2 muaj tjerë vijues(posedon dokumentacion mjekësorë), zvogëlim te aktivitetit te përgjithshëm jetësor nuk ka, shëmtim trupor nuk ka, përkujdesja e personit tjetër ka qene e nevojshme ne kohe zgjatje prej 3 jave, ushqimi i përforcuar

ka qene i nevojshme ne kohe zgjatje prej 3 jave dhe rehabilitim fizioterapeotik ka qene i nevojshëm ne kohe zgjatje prej 10 ditëve ne vitin e pare pas aksidentit.

Konstatimin dhe mendimin profesional dhe sqarimet shtese te dhëna ne prani te palëve te cilën palët ndergjyqese nuk e kontestuan, gjykata i dha besimin e plote kësaj ekspertize.

Nga raporti zyrtar lidhur me aksidentin ne pune nr.1547 i dt:17.08.2022 i hartuar nga inspektori i punës është konstatuar se paditësi ka deklaruar se me dt.10.07.2010 kishte lënduar dorën e majtë dhe nxjerr gishtin ndërsa me dt:17.07.2020 ne Prishtinë kishte lënduar këmbët dhe lëndimi i te punësuarit B.J.me dt:10.07.2020 ne fshatin... nuk munde te vërtetohet me asnjë prove edhe për kundër deklaratës se tije se e kishte lënduar dorën e majtë, nxjerr gishtin, lënduar fizikisht dhe psiçikisht dhe e paditura nuk ka kontratë pune me te punësuarin B.J.me arsyetim se ka qen ne pune provuese.

Nga raporti zyrtar lidhur me inspektimin e kryer ne subjektin juridik T... –shpk i dt:16.09.2020 i hartuar nga inspektoret e punës me rastin e inspektimit te aksidentit lidhur me lëndimin ne vendin e punës i cili ka ndodhur me dt:17.07.2020 i cili ka ndodhur ne punishten e subjektit juridike A... ndërsa pune kryerës T..., kurse rasti është paraqitur ne inspektoriat te punës me dt:27.07.2020 nuk ka pasur mundësi te konstatoi se si ka ardhur deri te aksidenti ne te cilin rast supozohet se ankuesi (paditësi) ka pasur lëndime te lehta trupore, pra a a është ne pyetje lëndimi nga rrëzimi apo vetëm te gërrithura gjate punës por është konstatuar se ka pësuar lëndime bazuar ne raportin mjekësorë, ndërsa pune dhënësi ka lëshime për mos njoftimin e inspektoriatit te punës lidhur me aksidentin, është konstatuar se nuk posedoni kontratë te punës ne forme te shkruar.

Prokuroria Themelore ne Peje –Departamenti për Krime te Përgjithshme me aktvendimin PP/II nr.1480/2020 me dt:14.10.2020 e ka hedhur kallximin penal i parashtruar kundër te dyshuarit B.L. pasi qe nuk ekziston dyshim i arsyeshëm se është kryer vepra penale apo ndonjë vepër tjetër e cila do te ndiqej sipas detyrës zyrtare, pasi qe përpos deklaratës se te dëmtuarit nuk kemi asnjë prove tjetër qe e qonë deri te dyshimi i arsyeshëm se i dyshuari kishte kryer vepër penale.

Dëshmitari B.K. u deklarua se jam ne marrëdhënie pune tek e paditura dhe sa i përket pretendimeve te B. se është lënduar ne Veternik deklaroi me përgjegjësi te plote se nuk është lënduar dhe nuk ka pasur kurrfarë lëndimi sepse sikur te ish lënduar është dashur me e dërguar tek mjeku ku kemi qene duke punuar ne vendin e punës ne Veternik me dt:17.07.2020.

Dëshmitari A.B. u deklarua se kemi qene se bashku me B. me pune ne... nuk e kam pare si është lënduar mirëpo kemi punuar edhe ne Veternik ku kemi qene se bashku dhe e kam pare se është gërvishtur duke punuar ne vendosjen e pllakës, pra është gërvishtur ne këmbë dhe ka vazhduar punën deri ne përfundimin e orarit, por ka qene ne pune edhe pasi është lënduar por nuk me kujtohet kohëzgjatja.

Dëshmitari Ç.M. deklaroi se kemi qene duke punuar ne Peje ne ,mes tjerëve punëtor ka qene edhe B.J.dhe ka ndodhur një incident ne vendin e punës me qe rast kemi pësuar lëndime trupore unë dhe një shok i imi i quajtur A.B. dhe kemi marre ndihmën e pare mjekësore ne vendin e punës ndërsa sa i përket B. i njëjti nuk është lënduar ne ketë vend te punës dhe nuk ka marr ndihme mjekësore.

Gjykata erdhi ne përfundim se ne ketë çështje juridike-civile ekziston përgjegjësia e ndare e te paditurës qe ka përgjegjësin primare, fakt i cili u bazua ne mendimin e ekspertit për mbrojtje dhe siguri ne pune, sepse ka qene i detyruar te zbatoi masat parandaluese bazuar ne detyrimet dhe parimet e përgjithshme me ligjin qe ka qene ne fuqi kur ka ndodhur lëndimi, ndërsa paditësi ka

përgjegjësi sekondare për lëshimet që ka bërë pasi që nuk është përkujdesur për sigurinë dhe shëndetin e vetë si person profesional për punën që ka kryer.

Ne bazë të përgjegjësisë së ndarë, gjykata caktoi edhe shumën e kompensimit të demit material dhe jo material që paraqesin një satisfakcion për paditësin që është i arsyeshëm dhe objektiv që me këto mjete të plotësohen nevojat dhe të mirat materiale, që për ndryshe nuk paraqesin kompensim absolut të demit në kuptim të nenit 176.1 të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore .

Me rastin e vendosjes së lartësisë së demit për të gjitha bazat gjykata pati parasysh rrethanat siç janë, përgjegjësia e ndarë, lëndimet trupore që ka pësuar paditësi si dhe moshën e paditësit.

Gjykata refuzoi pjesën e kërkesëpadisë mbi shumën e aprovuar si në pikën II, në dispozitiv të aktgjykimit si të jetë të lartë e në veçanti për shkak të përgjegjësisë së ndarë.

Për kamatën ligjore gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata pjesën e kërkesë padisë për kompensimin e demit material dhe jo material që pretendon paditësi se iu është shkaktuar në vendin e punës tek e paditura në fshatin... e refuzoi si të pa bazuar sepse me asnjë provë nuk u vërtetua se paditësi ka qene i lënduar me dt:10.07.2020 e cila rrethane u vërtetua nga deklarimi i dëshmitarëve B.K., A.B., Ç.M. të cilët në mënyrë të kurtë deklaruan se paditësi nuk ka pësuar lëndime në këtë vend të punës dhe me këtë datë, andaj gjykata vendosi si në pikën IV. në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Për shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata u bazua në nenin 452.2 të Ligjit Procedurës Kontestimore, në të cilat shpenzime janë llogaritur për hartimin e padisë shuma prej 104 euro, taksë gjyqësore për padi në shumë prej 30 euro, për precizimin e padisë shuma prej 104 euro, për ekspertizat nga mbrojtja dhe siguria në punë shumën prej 380 euro, për ekspertizë mjekësore shumën prej 300 euro, për shtat përfaqësime në seanca nga 135 euro për një seancë në shumë prej 945 euro, e në shumë të përgjithshme prej 1863, ndërsa për tri seanca të pa mbajtura në shumë prej 405 euro u refuzua si e pa bazuar.

Gjykata duke u bazuar në nenet 6,7, 18 Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë(Ligji nr.04/L-161), dhe lidhur me nenet 136, 176, 179, dhe 183 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata duke u bazuar në nenin 143 Ligji i Procedurës Kontestimore vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ**

Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.394/2020 me dt.18.01.2024

Gjyqtari,  
Avdulla Mecinaj

Numri i lëndës: 2020:131587  
Datë: 08.03.2024  
Numri i dokumentit: 05428437

**UDHËZIME JURIDIKE:** Palët kanë të drejtën e parashtrimit të ankesës në Gjykatën e Apelit në Prishtinë - përmes gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Skenderaj, në afat prej 15 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.